



Mekanizma mbrojtës nga dhuna online

MANUAL PËR
GAZETARË

Mekanizma mbrojtës nga dhuna online

Manual për gazetarë

Lejla Gaçanica dhe Marija Arnautoviç



Manuali është një përshtatje nga Instituti Shqiptar i Medias për kontekstin shqiptar i manualit “Mbrojtje nga Sulmet online: Manual për gazetarët nga Lejla Gačanica dhe Marija Arnautović (Mediacentar Sarajevo, 2018).”

Botues: Instituti Shqiptar i Medias
Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania
Tel./fax: ++ 355 4 2229800
E-mail: info@institutemedia.org
www.institutemedia.org

Faqosja: Bujar Karoshi

Përmbajtja

Pse ky manual?	5
Si të përdoret manuali?	7
1. Hapësirë paralele, rregulla paralele	9
2. Çfarë mund të jenë sulmet online?	11
2.1 Shpifja	12
2.2 Presionet	16
2.3 Kërcënimet online	19
2.4 Gjuha e urrejtjes	20
2.5 Diskriminimi	22
2.6 Forma të tjera të shqetësimeve/sulmeve online	24
3. Si të mbrohesh	27
4. Terma	35
Literatura	39
Rreth autoreve	45

#godigitalagainsttharassment

Pse ky manual?

Mbrojtja më e mirë është ta denoncosh dhunën online

Interneti ka sjellë një ndihmë të pazëvendësueshme në punën e gazetarëve dhe gazetareve. Por ka sjellë edhe atë që tekstet, komentet, analizat, videot dhe historitë e tjera gazetareske të komentohen **anonimisht** dhe shpesh të shoqërohen me kërcënime, gjuhë urrejtjeje, presione, diskriminim.

Dy janë problemet e njohur kur është fjala për sferën online dhe gazetarinë. I pari, padyshim, ka të bëjë me faktin se sfera e komenteve online është e parregulluar nga ana ligjore, çka do të thotë se, si e tillë, lë hapësirë për individë të papërgjegjshëm që besojnë se të fshehur pas anonimatit ose profileve të rremë në rrjetet sociale mund t'i kërcënojnë gazetarët pa u ndëshkuar. Problem i dytë është se, në pjesën më të madhe të rasteve, redaktorët dhe gazetarët nuk dinë në ç'mënyrë të ballafaqohen me dhunën online dhe për këtë arsye shpesh ajo nuk denoncohet.

Kur themi se hapësira online është “e parregulluar nga ana ligjore”, kemi parasysh atë që kuadri ligjor ekzistues lidhur me sulmet ndaj gazetarëve duhet të “përkthehet” edhe për hapësirën online, e cila ka rregulla të tjera funksionimi dhe se në proces konsiderohet si diçka e parrezikshme, ndaj dhe më pak i rëndësishëm.

Pikërisht për të gjitha këto lindi manuali, i konceptuar fillimilist në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe pastaj i përshtatur në të gjitha vendet e rajonit, të cilat kanë një problematikë të ngjashme në këtë aspekt. Udhëzuesi përmes kuadrit ligjor ekzistues mund t'iu vijë në ndihmë gazetarëve për t'u përballuar me dhunën online në të gjitha format që shfaqet. Po kështu udhëzuesi ka për qëllim të mbushë dhe një boshllëk edhe për faktin se shpesh

mungon përkrahja e redaktorit dhe e redaksisë ku gazetari punon për shkak të mendimit mbizotërues se ajo çka është online i përket një bote virtuale dhe se nuk përçohet në botën reale.

Edhe pse nuk ka të dhëna apo monitorime për sulmet online ndaj gazetarëve në Shqipëri, është e lehtë që të gjithë përdoruesit e medias online dhe rrjeteve sociale të përballen rëndom me fyerjem sharje e kërcënime, dhe ata që botojnë artikuj apo drejtojnë emisione janë ndër shënjestrat më të shpeshta të këtij komunikimi online, edhe pse, siç ndodh rëndom, këto sulme shpesh nuk merren shumë seriozisht. Po kështu nuk ka të dhëna për denoncime apo për raste ku policia ndërmerr hetime dhe këto raste arrijnë në gjykatë. Provider-at dhe administratorët e faqeve të Internetit e kanë për detyrë të ruajnë të dhënat private të vizituesve të faqes, me përjashtim të rasteve kur për një arsye ose një tjetër kundër vizitorit të faqes ngrihet padi në polici, atëherë ata janë të detyruar të bashkëpunojnë dhe të bëjnë të mundur aksesin në statistikat, në mënyrë që dhunuesi të identifikohet dhe të gjendet. Shpesh harrohet, ndaj është me vend të kujtohet këtu, se çdo kompjuter ka adresën e vet IP, e cila mund të konsiderohet edhe si “letër njoftimi”.

Ky manual iu ofron gazetarëve këshilla dhe udhëzime se si të dallojnë e të reagojnë ndaj sulmeve online. Ndër hapat e parë është ai i ndërgjegjësimit përkundrejt këtij problem. Ne besojmë se manuali do t'i inkurajojë gazetarët të denoncojnë sulmet online, si dhe të ndikojë që ata vetë të japin kontribut për ndërgjegjësimin dhe ndalimin e dhunës online.

#godigitalagainsttharassment

Si mund të përdoret manuali?

Manuali përbëhet nga katër kapituj – hyrja, pjesa e përgjithshme që përkufizon kuadri ligjor për sulmet online ndaj gazetarëve; përshkrimi i sulmeve të veçanta online; këshilla se si të sillësh e çfarë mund të bësh për t'u mbrojtur; terminologji. Ideja është për të identifikuar llojet e sulmeve online e për të udhëzuar se si të mbrohesh dhe/ose të sigurosh të drejtat e tua. Në kapitullin 2 nën përshkrimin e llojeve të veçanta të sulmeve online gjenden edhe një sërë mënyrash për t'u mbrojtur, ndërsa në kapitullin 3 renditen hollësisht mënyrat praktike të mbrojtjes me kontaktet e dhura dhe formularët përkatës. Në kapitullin 4 manuali përmban terminologji – të gjithë termat e shenjuar me ngjyra të ndryshme në tekst kanë përkufizimin e tyre në fjalorthin e termave. Shprehje që për hir të transparencës jepen sipas një gjinie gramatikore në krejt manualin pa kurrfarë diskriminimi të raporteve mashkull femër.



#godigitalagainsttharassment

01

Hapësirë paralele Rregulla paralele?

Nuk ka të dhëna të sakta se sa gazetarë në Shqipëri kanë qenë të ekspozuar ndaj kërcënimeve ose sulmeve online. Por prirjet e komunikimit online tanimë flasin qartë se interneti është një hapësirë që nuk ofron thuajse kurrfarë garancie për gazetarët. Deri më sot janë shënuar kërcënime, fyerje ose përçmime, të cilat bëjnë thirrje haptazi për urrejtje dhe shpesh edhe për ta linçuar aksh gazetar.

Sulmet kundër gazetarëve realisht janë sulme ndaj parimeve të lirisë së shprehjes, të drejtës për informim, pluralizmit të mendimit dhe të informacionit, parime që janë postulate të rëndësishëm të një shoqërie demokratike dhe në promovimin e të cilave gazetarët luajnë një rol të posaçëm. Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve, sulmet online drejtuar kundër gazetarëve në thelb nuk denoncohen dhe nuk procedohen, duke qenë se si gazetarët ashtu edhe gjykatësit nuk i marrin seriozisht sa e si ç’duhet.

E drejta e lirisë së shprehjes garantohet nga kushtetuta e Shqipërisë si dhe e dokumenteve ndërkombëtare që kushtetuta i referohet. Kjo është një e drejtë e përgjithshme që përfshin të drejtën për të menduar dhe të drejtën për të kërkuar, marrë dhe përcjellë informacion dhe ide të të gjitha llojeve pa hasur në pengesa dhe pa përfillur kufitë. Nuk ka ligje të cilët mbrojnë posaçërisht gazetarët, por në mënyrë të tërthortë, të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve mbulohen edhe nga ligje të tjera, siç është legjisllacioni penal dhe civil për shpifjen, por edhe në kuadër ligjesh të tjera, siç është ligji për ndalimin e diskriminimit, ligji

për barazinë gjinore, apo Kodi i Punës. Në vitin 2002 Shqipëria ratifikoi Konventën për krimet kibernetike të Këshillit të Europës të vitit 2001. Dispozita të Konventës janë përfshirë edhe në kodin penal (si normativat për dëmtimin e të dhënave dhe programeve kompjuterike, sabotimi kompjuterik).

Liria e shprehjes përshkruhet në:

Neni 10. Konventa europiane për të drejtat e njeriut

Neni 19. Paktet ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike, si dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare e rajonale.

Duhet përmendur edhe Kodi i Etikës së Gazetarit apo udhëzime të tjera profesionale që synojnë të vetërregullojnë mediat, edhe pse ky ka qenë një proces tejet i ngadaltë në Shqipëri. Të gjithë këto dokumente nuk kanë fuqi ligjore, por janë elemente thelbësore për të ndërtuar integritetin mediatik në mediat shqiptare.

Përgjegjësinë për përmbajtjen e materialeve online patjetër që e kanë edhe **redaktorët** e mediave – si për autorët e teksteve, përmbajtjen e tyre, ashtu edhe për komentet që (më së shumti) **përdoruesit anonimë** lënë poshtë teksteve. Në Shqipëri janë ndjekur dy modele kryesore për komentet: ose ato bllokohen krejt pa mundësi komentimi, ose ato lihen krejtësisht të hapura, pa asnjë ndërhyrje

për ofendime, sharje, diskriminim, gjuhë urrejtje, etj. Shpesh kjo qasje e dytë është parë edhe si model biznesi nga disa media online, gjë që nuk nxit aspak një model etik komunikimi në këtë hapësirë të medias online. Rastet e ndërmjetme, ku komentet moderohen, janë tejet të pakta dhe efikasiteti i këtij moderimi mbetet në pikëpyetje. Filtrimi i komenteve është shembull i një praktike të mirë për ndalimin e gjuhës së urrejtjes, fyerjeve, diskriminimit dhe në përgjithësi dhunës online, çka është edhe një aspekt i rëndësishëm i përgjegjshmërisë redaktoriale. Gjithsesi, nga anketat dhe intervistat me përfaqësues të medias online, stafi në këto redaksi është tejet i pakët për t'u kushtuar kohë dhe vëmendje komenteve online, ose lënia e lirë e komenteve shihet si një mundësi për më shumë klikime për median online. (ISHM, Peizash i medias online në Shqipëri, 2018)

Filtra të këtyllë, me ndihmën e të cilëve komentet mbërrijnë më parë në redaksi përmes e-mail-eve, e më pas, mbasi shihen prej redaktorëve, mund të botohen nën tekstin në fjalë, kanë, fjala vjen, redaksitë e Zërit të Amerikës, Radios Europa e Lirë. Në mënyrë që komenti juaj të botohet, ndër të tjera, është e domosdoshme që të lini edhe adresën e e-mail-it.

Brenda kornizës ligjore që rregullon punën e gazetarit, integritetin dhe sigurinë, nuk i është kushtuar një vend i veçantë (me fjalë të tjera nuk është standardizuar) hapësirës online. Gjithsesi sulmet online ndaj gazetarëve mund të ndiqen penalisht përmes disa ligjeve të ndryshme, përmes procedurave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore të cilat standardizojnë në përgjithësi raste e sulmeve (procedurë penale, procedurë shkeljeje, procedurë ligjore, procedurë specifike në rast diskriminimi, ankesë drejtuar shoqatës së gazetarëve, ndihmë juridike falas). Është e nevojshme të theksohet se këto lloj sulmesh janë specifike, ndaj dhe

denoncimi i tyre kërkon mekanizma specifike, me çka do të merremi në kapitujt 2 dhe 3 të manualit.

Një mangësi serioze për një analizë të thellë dhe vlerësimin e gjendjes lidhur me sulmet ndaj gazetarëve është mos ekzistimi i një regjistri, me fjalë të tjera pamundësia e evidentimit të objektit që ka të bëjë me kërcënimet ose sulmet kundër gazetarëve në bazë të të dhënave që përbëjnë objektin e punës së gjyqësorit. Më saktë prokuroria dhe gjykatat nuk përmbajnë statistika për veprën penale duke u nisur nga profesioni i personit.

Ajo që ndodh online mbetet online? Jo e saktë. Ajo çka ndodh online ndikon dhe ka pasoja në realitet, në botën offline – Interneti është pjesë e jetës reale. Pikërisht për këtë gjë sulmet online duhen konsideruar të vërteta dhe për këtë gjë duhet siguruar mbrojtje adekuate.

02

Çfarë mund të quhet sulm online?

Sulmet online kundër gazetarëve përfshijnë forma të ndryshme sulmesh dhe kanale të ndryshme (komentet, mesazhet private, hakerimi i faqes etj.). “Dhuna online” është emëruesi i përbashkët për forma të ndryshme sulmesh përmes internetit, e cila përfshin shqetësimet, kërcënimet, cenimin e integritetit, informacionet e rreme. Ajo çka e karakterizon dhunën online, duke e bërë atë më të përhapur e më të shfrenuar, është anonimat (fshehja e identitetit me anë të nickname/pseudonimeve), disponueshmëria (kontakti me

viktimën me anë të internetit në çfarëdo ore dhe nga çfarëdolloj vendi), disinibicioni (mungesa e vetëpërmbytjes dhe e vetëkontrollit, një mënyrë sjelljeje që me shumë gjasë nuk ndodh offline, në realitet).

Për nevojat e manualit kemi veçuar sulmet që janë kryer më shpesh ndaj gazetarëve online, të cilat kategorizohen sipas veprës: shpifje, presion, kërcënim, gjuha e urrejtjes, diskriminim, forma të tjera dhune.

2.1. Shpifja

Përshkrim i veprës dhe rregullimi ligjor

Shpifja është cenimi i personit fizik ose personit ligjor, duke shprehur fakte të pavërteta që identifikohen me personin fizik ose atë ligjor në vetë të tretë. Siç shprehet Srđić: “objekt i përhapjes ose paraqitjes mund të jenë vetëm pretendime që lidhen me një ngjarje të caktuar, gjendje objektive, veprime, shfaqje e gjëra të ngjashme, vërtetësia e të cilave mund të vërtetohet ose të vlerësohet objektivisht, ndërsa pohimet që përfaqësojnë vetëm gjykaimin e vlerës nuk mund të konsiderohen shpifje” (te Halilović dhe Xhihanna 2012: 134). Përmbajtja e pretendimit duhet të lidhet me veprime, ngjarje dhe gjëra të ngjashme nga e kaluara ose e tashmja, ndërsa pretendime për ngjarje eventuale ose në të ardhmen nuk kanë vlerë ligjore.

Shpifjen në hapësirën online mund ta karakterizojmë si shkrim gjërash të pavërteta në portale ose rrjetet shoqërore kundër gazetarit me qëllim për të diskredituar punën e tij.

Edhe pse gazetarët në rastin e shpifjes më së shumti gjenden në anën e të akuzuarit, shpifja jo rrallë përdoret edhe për t'i diskredituar vetë gazetarët. Nuk ka të dhëna statistikore mbi çështjet e shpifjeve kundër organeve të medias dhe gazetarëve. Po të kemi parasysh edhe vendimet e shumë gjykatave në vend për të fshehur identitetin e palëve të përfshira në procese gjyqësore, atëherë do të bëhet akoma edhe më e vështirë që të përcaktohet numri i saktë i këtyre çështjeve. Ministria e Drejtësisë raporton të dhëna vjetore mbi numrin e përgjithshëm të çështjeve dhe dënimeve për shpifje, por jo të dhëna specifike për çështjet ndaj gazetarëve. Po kështu, procedurat në gjykatë merren dhe regjistrohen ashtu si të gjitha procedurat për shkaktim dëmi, pa bërë dallim nëse çështjet janë kundër medias apo gazetarëve.

Në Shqipëri shpifja rregullohet me anë të Kodit Penal dhe Kodit Civil. Edhe pse reforma ligjore e miratuar në vitin 2012 bëri mjaft ndryshime në kuadrin ligjor për shpifjen dhe fyerjen, nuk u arrit deri në një dekriminalizim të plotë të tyre. Kështu, shpifja rregullohet me nenin 120 të Kodit Penal, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë, ose deri në tre milionë lekë nëse bëhet botërisht ose në mënyrë të përsëritur. Shpifja përkufizohet si “përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër që dihet se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit.”

Përsa i përket Kodit Civil, dëmi jopasuror (Neni 625), mendohet se ka ndodhur atëherë kur personi:

- Ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- është cenuar drejta e emrit;
- është cenuar respektimi i jetës private;
- është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.

Ndryshimet e bëra në Kodin Civil në vitin 2012 përcaktuan një listë të gjatë kriteresh që duheshin patur parasysh kur të vlerësohej përgjegjësia civile në lidhje me dëmtimin e nderit dhe reputacionit të një individi. “Dispozitat e reja ligjore përcaktojnë 11 faktorë specifikë jo-shterues që duhen marrë parasysh nga gjykatat për të përcaktuar përgjegjësinë.” (D. Pavli, në Comparative study of best European practices of online content regulation: Law and policy of online content regulation, in particular defamation online, in the light of Albanian legislative proposals.)

Përcaktues të rëndësishëm ligjorë lidhur me shpifjen:

Në këto raste duhet të shikohet:

- nëse deklaratat në media janë paraqitur si fakt apo opinion;
- nëse janë të vërteta apo të rreme, nëse i referohen saktësisht thënieve të një pale të tretë;
- nëse kanë lidhje me një ‘çështje me interes publik, persona në poste qeveritare, apo që konkurrojnë në zgjedhje’;

- dhe nëse autori ka respektuar regullat e etikës profesionale (për shembull në rastet e mediave dhe profesionistëve të fushës së informimit).”

Sidoqoftë shoqatat që mbështetin lirinë e shprehjes shprehin shqetësimin se pavarësisht listës së detajuar që duhet të orientojë gjykatësit, gjykimet civile mbartin rrezikun e gjobave dhe penalizimeve më të larta që mund të vendosen edhe në mënyrë arbitrare. (D. Pavli, në Comparative study of best European practices of online content regulation: Law and policy of online content regulation, in particular defamation online, in the light of Albanian legislative proposals.)

Gjykata europiane për të drejtat e njeriut ka mbajtur një qëndrim të prerë: askush nuk mund e duhet të pengohet të shprehë mendimet e veta. Shprehje mendimi është: këndvështrimi i një gazetari ose autori dhe kuptimi nga ana e tij e një fakti të caktuar. Kjo është diçka e ndryshme nga vetë fakti. (Liria e shprehjes, ligji për shpifjen nga mediat dhe gazetarët).

- Gjykata e vlerëson masën e dënimit për çdo rast konkret. Kompensimi duhet të jetë në përpjesëtim me dëmin e bërë ndaj reputacionit të palës së dëmtuar dhe përcaktohet me qëllim të kompesimit të dëmit të kryer.
- Nuk ekziston më mbrojtja e posaçme për personat publikë në lidhje me shpifjen, por nuk ka as ndalesë të këtyre padive nga ana e personave apo zyrtarëve publikë.

Në paditë për shpifje barra e provës i takon palës paditëse, pra ajo duhet që të demonstrojë vërtetësinë e padisë. Normalisht kjo vlen edhe për shpifjet e kryera në hapësirën online. Vëmendja duhet të përqëndrohet në evidentimin e nevojshëm të burimit, të datës dhe atij që ka kryer aktin e shpifjes online.

#si ta dallosh shpifjen?

Shpifja konsiston në dëmtimin që i bëhet reputacionit të dikujt përmes paraqitjes dhe transmetimit të fakteve të rreme në lidhje me një person fizik ose juridik një pale të tretë, duke ditur se ky informacion është i rremë dhe duke e përhapur qëllimisht atë.

- Fakt të pavërtetë mund të përbëjë përshkrimi i pavërtetë që i bëhet gazetarit (për shembull, kriminel), të dhënat e pavërteta për gazetarin (për jetën private, arsimimin, bindjet politike, për pjesëmartjen në luftë etj.), të dhënat e pavërteta për tekstin/kontributin/emisionin që firmoset nga gazetari (financimin/sponsorizimin, shtrembërimin e qëllimtë të përmbatjes/faktit etj.).

- Fakti/informacioni/materiali i pavërtetë që është transmetuar në një portal online dhe kjo gjë është bërë në një artikull, koment, reklamë. Po kështu edhe nëse është publikuar në rrjetet sociale (Facebook, Twitter e kështu me radhë).
- Njoftimi i rremë i referohet një personi specifik me synimin për të dëmtuar reputacionin ose nderin e personit. Jo rrallë kjo gjë shtrihet edhe te pjesëtarët e familjes së gazetarit, për çka është e nevojshme interpretimi i tekstit në tërësinë e vet (me fjalë të tjera lidhjen me personin e caktuar për shkak të dëmit të kryer).
- Në teori shpifje përbën edhe dëmtimi i kryer në hapësirën online në qoftë se përmban elemente të pavërtetë.

#çfarë mund të bëhet?

Mbrojtja e punës gazetareske nga shpifja:

- Në përgatitjen e shkrimit – të verifikojë informacionin (të kontaktojë me sa më shumë burime, duke përfshirë edhe subjektin për të cilin bën fjalë shkrimi), saktësi në shkrim (veçanërisht duke bërë dallimin midis faktit dhe opinionit), grumbullimi i materialit mbështetës për punën e kryer (arkivimi i shënimeve dhe i të dhënave për burimet).

Mbrojtja e gazetarit nga shpifja:

- Padia për shpifje (procedura gjyqësore, procedurë civile)
- Kërkesa për publikimin e korigjimit të pretendimit (demantimi/mohimi)
- Shfrytëzimi i instrumenteve online për të raportuar përmbajtjen e papërshtatshme
- Thirrje për ndihmë pranë shoqatave të gazetarëve

2.2. Presione

Përshkrimi i aktit dhe rregullimi ligjor

Presionet mbi gazetarët mund të jenë politikë, ekonomikë, si dhe të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në hapësirën online presionet e drejtuara ndaj gazetarëve mund të shfaqen përmes mobing, shqetësimeve, ngacmimeve seksuale ose në mënyrë të tjera.

Mobing, i përkufizuar si “shqetësim” sipas Ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit (neni 4) është “ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”. Kjo formë presioni mund të ushtrohet përmes komunikimeve me e-mail, censurës e veprimeve të ngjashme.

Po kështu, sipas Kodit të Punës, “Shqetësim seksual është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike e simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin edinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, përcmues ose fytes, që kryhet ngapunëdhënësi kundrejt një punëmarrësi, një punëkërkuesi për punë ose midis punëmarrësve.” (Kodi i Punës, neni 32). Gjinia shpesh përdoret si bazë diskriminimi dhe sulmi ndaj personalitetit të gazetarit – në hapësirën online fillohet me fyerje që kanë të bëjnë me pamjen fizike për të përfunduar në kërcënime eksplicite që bëhen publikisht (komente, statuse) dhe privatisht (e-mail, mesazhe në rrjetet sociale) që bazohen te gjinia. Ngacmimi seksual rregullohet me Kodin Penal, Kodin e Punës, Ligjin për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, si dhe Ligjin për Barazinë Gjinore në Shqipëri.

Katër janë elementet bazë përplotësimi i të cilave është i nevojshëm për të përcaktuar një sjellje si ngacmim nisur nga seksi ose ngacmim seksual: element subjektiv (Akt/sjellje e padëshiruar – të gjitha sjelljet e natyrës seksuale ose që lidhen me sjellje të papërshtatshme drejtuar personave për shkak të gjinisë së tyre), veprimet ngacmuese (aktet e sjelljes verbale jo verbale sikurse janë fjalët dhe komentet fyese, thirrjet për takim dhe flirtim të padëshiruar, bërja

e komenteve dhe aluzioneve të natyrës seksuale), natyra e aktit (ngacmime për shkak të karakteristikave gjinore, të jashtme, fizike ose biologjike të një personi qoftë ky i gjinisë mashkullore ose femërore) dhe dhe pasojat (shkelja e dinjitetit të një personi ose të një grupi personash që vuajnë nga ngacmimet me bazë gjinore ose ngacmimet seksuale, domethënë në krijimin e një mjedisi të frikshëm, armiqësor, degradues, degradues ose abuziv).

Këta elementë duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Nëse disa prej elementeve nuk përmbushen, kjo gjë mund të përbëjë një formë tjetër e ngacmimit ose ndonjë formë tjetër diskriminimi, siç është mobilizimi ose dhuna me bazë gjinore.

Si ta dallosh?

#mobing

Mobing ose shqetësimi në vendin e punës shpesh quhet “abuzim në punë” – viktimat e këtij lloji presioni mund të jenë vetëm personat e punësuar, thënë me fjalë të tjera personat e angazhuar me punë. Në qoftë se ka shkelje të të drejtave që lidhen me punën që kryen një person i caktuar, imponime dhe sjellje që nuk parashikohen nga vendi i punës që ai ka pranuar të kryejë, të cilat e cenojnë në punë ose e shtrëngojnë të jap dorëheqjen, atëherë kemi mobing ose shqetësim. Komunikimi online në këtë rast është diçka themelore: gjithnjë e më shumë mobing sot mund të ndodhë përmes kanaleve të komunikimit që mundëson interneti.

- Pamundësia e një komunikimi adekuat dhe ruajtja e kontakteve sociale: viktimat izolohehen vazhdimisht; mosthirrja në takimet e përbashkëta; heqja nga lista e korrespondencës me e-mail; mos dhënia e mundësisë për të bërë komente; ngacmime përmes rrugëve e mjeteve të komunikimit (e-mail ose mesazhe me përmbajtje fyese ose poshtëruese).
- Presione në punë dhe aktivitetin profesional – kritika dhe qortime të vazhdueshme; refuzim i vazhdueshëm i punës pa arsye konkrete; fyerje; përcaktim i afateve të shkurtra për kryerjen e punës; ndryshime të vazhdueshme të detyrave të punës; ngarkimi me detyra poshtëruese ose tejet të rënda, veçanërisht asish që janë nën ose larg nivelit të dijeve dhe kualifikimit të të punësuarit; ngarkim me detyra të papërshtatshme që nuk kanë lidhje me vendin e punës ku personi punon; mbikëqyrje në mënyrë të ekzagjeruar të punës; përdorimi i pabazë i mjeteve teknike për ta kontrolluar të punësuarin (duke përfshirë këtu edhe hyrjen në e-maile të punës); mosinformimi në mënyrë të qëllimshme për

çështje që lidhen me punën; përjashtimi në mënyrë të qëllimtë dhe të pajustificuar të të punësuarit nga arsimimi dhe trajnimi profesional.

- Sulme që drejtohen kundër reputacionit personal: marrje nëpër gojë; trillim historik nga jeta personale e viktimës; komente negative.

#ngacmimi seksual

- Komente poshtëruese dhe të papërshtatshme, si dhe veprime të natyrës seksuale që kryhen përmes e-mailit të punës ose atij privat, mesazhe në rrjetet sociale, komente publike online.
- Insinuata dhe shenja që i referohen marrëdhënieve seksuale.
- Kërcënime ose shantazhe të natyrës seksuale.
- Përcjellje përmes postës elektronike të pamjeve me përmbajtje të natyrës seksuale ose përmbajtje që shpalos pabarazinë në punë.
- Dërgimi ose vendosja e fotografive ose posterave me përmbajtje të natyrës seksuale ose përmbajtje fyese që lidhet me gjininë.
- Fyerje lidhur me seksin e personit ose vlerësime që nxjerrin në pah gjininë e dikujt.
- Kushtëzimi i karrierës në punë ose përfitimi i të mirave të tjera falë shërbimeve seksuale.

#çfarë mund të bëhet?

- Ankesë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Ankesa të veçanta për mbrojtjen nga diskriminimi (duke përfshirë këtu mobing dhe/ose ngacmimin seksual)
- Shkeljet
- Padi (procedurë civile sipas Kodit të Punës)
- Denoncim/kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore (mobing dhe ngacmim seksual)
- Shfrytëzimi i instrumenteve online për të denoncuar përmbajtje të papërshtatshme
- Ankesa pranë shoqatave dhe organizatave të gazetarëve

2.3. Kërcënime online

Përshkrimi i punës dhe rregullimi ligjor

Kërcënimet e drejtpërdrejta me vdekje, kërcënimet për dhunë fizike ndaj gazetarit ose familjes së tij, si dhe kërcënimet implicite hyjnë në kategorinë e sulmeve online kundër gazetarëve.

Kodi Penal në nenin 84 përcakton se “kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.” Teorikisht këtu mund të hyjnë edhe sulmet apo kërcënimet online.

Po kështu, neni 121/a në Kodin Penal e përcakton përndjekjen si “kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet.”

#si ta dallosh kërcënimin?

- Mesazhe shqetësuese me kërcënime për jetën dhe integritetin e marrësit dërguar me celular, e-mail ose në chat.
- E-mail-e, komente, statuse, blogje që përmbajnë kërcënime me vdekje ose me dhunë fizike.
- Përgjime (ndjekje) në Internet (cyberstalking) përmes internetit ose mjeteve të tjera elektronike për përgjimin ose shqetësimin e individit, grupeve ose organizatave, duke përfshirë këtu mbikëqyrjen, përvetësimin e identitetit, kërcënimin, vandalizmin, mbledhjen e informacionit që mund të ridimensionohet për t’u shfrytëzuar për fyer ose shqetësuar dikë.
- Thirrjet për të cenuar sigurinë e gazetarit dhe/ose redaksisë (duke përfshirë si të punësuarit ashtu edhe bashkëpunëtorët).
- Kërcënime të tërthorta si: “E di ku banon ti/ ku banon familja tënde” e gjëra të ngjashme.

#çfarë mund të bëhet?

- Kallëzim penal
- Padi
- Përdorim i instrumenteve online për të denoncuar mesazhe me përmbajtje të papërshtatshme
- Ankesa pranë shoqatave dhe organizatave të gazetarëve

2.4. Gjuha e urrejtjes

Përshkrimi i veprës dhe rregullimi ligjor

Gjuhë urrejtje është çdo fjalë e shkruar ose e shqiptuar që degradon, poshtëron ose përhap urrejtje për një grup njerëzish ose një bashkësi që perceptohet si “ndryshe” për shkak të karakteristikave të saj, dhe/ose nxit urrejtjen ekzistuese përmes ligjërimit publik, duke e zhvilluar, fuqizuar dhe thelluar. Komentet në mediat online dhe rrjetet sociale, fjalimet publike dhe deklaratat e udhëheqësve politikë/religjiozë, organizatat e djathta, materialet e shtypura, grafitet etj., janë të gjitha forma të fjalimit publik që mund të nxisin dhe/ose të bëjnë thirrje të drejtpërdrejta për dhunë ndaj “të tjerëve” ose “të ndryshmëve”, ose për t’i përbuzura ata për shkak të të qenit ndryshe.

Nxitja e urrejtjes, ashtu si dhe gjuha e urrejtjes, nuk ka përkufizim të posaçëm në ligjet në fuqi në Shqipëri. Një pengesë serioze në praktikë përbën mungesa e përkufizimeve të koncepteve kyçe – përkufizimi i “urrejtjes”, “nxitja/përhapja”, “mosmarrëveshjes” dhe “intolerancës”, si elementë themelorë të këtyre veprave penale.

Kodi penal shqiptar nuk ka ndonjë përkufizim të gjuhës së urrejtjes, por mund të procedojë në kuadër të veprës penale të ngjalljes së urrejtjes kombëtare, racore e të besimit, mosmarrëveshjeve dhe intolerancës. Kështu, sipas nenit 265 të Kodit Penal “nxitja e urrejtjes ose grindjeve për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.”

Po kështu, “vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet” sipas nenit 266, i cili mbulon thirrjen për urrejtje nacionale. E megjithatë nenet e lartpërmendura të kodeve penale

nuk e njohin gjuhën e urrejtjes si vepër penale më vete në konceptin e saj, por atëherë kur ajo drejtohet ndaj grupeve të caktuara, si dhe lënë të nënkuptohet se kërkohet dëshmi për ta vërtetuar këtë gjë, çka, në praktikën gjyqësore është vështirë të gjendet.

Ndërkohë, Kodi i Etikës i Gazetarit paralajmëron kundër botimit të informacionit apo pamjeve që nxisin gjuhën e urrejtjes. “Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës.” Po kështu, ai thotë se “çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individi, përveç rasteve kur gjykohet e rëndësishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim.” Ankesat për gjuhën e urrejtjes në media ose në internet mund t’i paraqiten Këshillit Shqiptar të Medias. Sidoqoftë, kjo organizatë nuk ka mekanizma për të vendosur sanksione mbi ata që shkelin parimin që ndalohet me ligj, pasi nuk është një organ kolegjial i redaksive të mediave. Me fjalë të tjera, Këshilli Shqiptar i Mediave mund të shqyrtojë rastin kur i paraqitet një ankesë, ta trajtojnë problemin dhe të bëj rekomandimet e duhura, por ai vetë nuk mund të ndërmarrë kurrfarë sanksioni dhe vendimet nuk janë detyruese për mediat. Veç kësaj Këshilli nuk ka kompetencë të shqyrtojë përbajtjen e atyre që publikohen në rrjetet sociale.

Me iniciativë të Komisionit Europian katër ndërmarrje të mëdha të IT-së (Facebook, Microsoft, Twitter dhe YouTube), në vitin 2016 paraqitën Kodin e sjelljes në luftë kundër gjuhës së paligjshme të urrejtjes në internet, si përgjigje ndaj përhapjes gjithnjë e më shumë të gjuhës së urrejtjes raciste dhe ksenofobe në internet. Kodit iu bashkuan edhe Instagram dhe Google +, dhe të gjithë nënshkruesit premtuan se në harkun e 24 orëve do të shqyrtojnë çdo denoncim për përdorimin e gjuhës së urrejtjes në internet.

#si mund të dallohet gjuha e urrejtjes?

- Thirrje e hapur për dhunë në platformat online, komentet, statuset.
- Nxitja, inkurajimi i urrejtjes.
- Më shpesh manifestohet përmes çështjeve nacionale, fyerjeve të besimit, mohimi i krimeve, afirmimi i doktrinës totalitare, politikave të ndryshme dhe orientimit seksual.
- Është e rëndësishme që të bëhet dallimi midis gjuhës së urrejtjes nga shpifja, fyerjet, ngacimimet, kërcënimet: gjuha e urrejtjes është publike; element bazë dhe kyç i gjuhës së urrejtjes është fyerja/shpifja, e megjithatë thirrja ose nxitja për urrejtje ndaj një grupi shoqëror është i mundur edhe pa fyerje/shpifje; fenomen shoqëruar i gjuhës së urrejtjes është edhe kërcënimi, edhe pse nuk është e thënë medoemos.

- Gjuha e urrejtjes i drejtohet një grupi njerëzish (vulnerabël), por jo individëve (në dallim nga fyerjet e zakonshme ose shpifjet që sulmojnë dinjitetin e individit, gjuha e urrejtjes ka të bëjë dhe i drejtohet një grupi të caktuar njerëzish).
- Bindës është ai që ka një qëndrim të caktuar përkundrejt grupeve të caktuara shoqërore dhe dëshiron që këtë qëndrim t'ua imponojë edhe të tjerëve.
- Gjuha e urrejtjes mund të bëhet bazë për lloje të ndryshme diskriminimi, por edhe ajo vetëm mund të jetë një lloj praktike diskriminuese, për shembull, në rast kur shprehet si ngacmim.
- Gjuha e urrejtjes inkurajon dhunën ndaj njerëzve.

#çfarë mund të bëhet?

- Denoncim penal
- Shfrytëzimi i instrumenteve online për të denoncuar rastet me përmbajtje të pahijshme
- Ankesë pranë Këshillit Shqiptar të Medias apo shoqatave të gazetarëve

2.5. Diskriminimi

Përshkrimi i veprës dhe rregullimi me ligj

Vepra e diskriminimit është ajo që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi e përkufizon diskriminimin si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Po kështu sulmet online ndaj gazetarëve mund të kenë dhe shpesh kanë elemente të gjuhës diskriminuese.

Ndalimi i diskriminimit vlen për të gjithë organet publike si dhe për të gjithë personat fizikë ose juridikë, në sektorin publik dhe atë privat, në të gjitha fushat e jetës. Institucioni qendror kompetent për mbrojtjen nga diskriminimi është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Çdo individ ose grup individësh që gjykon se diskriminohet mund të kërkojë t'i mbrohen të drejtat si në organet gjyqësore ashtu edhe ata administrativë, ndërkohë që procedura ka parimin e përparësisë. Barra e të provuarit se nuk ka pasur diskriminim peshon në krahun e kundërt.

Dispozita specifike kundër diskriminimit gjenden në një numër të madh ligjesh (përshtetull Kodi i Punës, Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligji për Mbrojtjen e Shëndetit, Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji për Familjen, etj.).

#si ta dallosh diskriminimin?

Diskriminimi në bazë të gjinisë/origjinës, për shembull kritika për sjelljen, pamjen, stilin e një personi konkret: shpërfillja dhe minimizimi i kontributit në punë dhe i rezultateve të arritura (e rëndësishme: të dallohet ngacmimi seksual dhe gjinor si bazë e diskriminimit)

- Trajtimi jo i barabartë i gazetarit/gazetares për shkak të përkatësisë kombëtare (refuzimi për ta informuar)
- Gazetari/gazetarja mund të diskriminohen në bazë të një sërë gjërash nga një fushë e caktuar (i ashtuquajtur "diskriminim i shumëfishtë" – psh, gjinor, përkatësia etnike, gjuhësore) se në bazë të një gjëje të caktuar nga fusha të shumta.
- Komentet diskriminuese në rrjetet shoqërore, ose komentet në portalet online drejtuar gazetarëve/gazetareve marrëdhëniet e të cilëve përmenden për keq

#çfarë mund të bëhet?

- Ankesë drejtuar institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit
- Padi të posaçme për t'u mbrojtur nga diskriminimi (duke përfshirë mobing dhe ngacmimin seksual)
- Shkelje
- Padi (Procedurë civile sipas Kodit të Punës)
- Shfrytëzimi i instrumenteve online për të denoncuar përmbajtje të papërshtatshme
- Ankesë me shkrim pranë shoqatave të gazetarëve

2.6. Forma të tjera të ngacmimeve/sulmeve online

Në këtë pjesë do të hidhet një vështrim i shkurtër për sulmet online ndaj gazetarëve dhe që nuk u shterruan në kapitujt e mëparshëm. Këto sulme ndodhin diçka më rrallë në Shqipëri dhe pothuajse nuk denoncohen dhe të gjykohen.

#krimi kibernetik

Krimi kibernetik ose kompjuterik rregullohet me anë të Kodit Penal në disa nene të tij. Neni 119/a dënon shpërndarjen e materialeve rasiste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik, ku thuhet se “ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.” Po kështu, në të njëjtin nen, paragrafi b, dënohet fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik, ku thuhet se “fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.”

Më tej edhe hyrja e paautorizuar kompjuterike ose hakerimi dënohet si vepër penale nëpërmjet nenit 192/b, i cili thotë: “hyrja e paautorizuar apo në tejkallim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cenimit të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.” Dënimet për kryerjen e kësaj vepre ndaj rrjeteve kompjuterike me siguri kombëtare dhe në përgjithësi rrjeteve publike parashikohet të jenë më të larta.

Së fundmi, ndalohet edhe përgjimi dhe dëmtimi apo ndërhyrja në të dhëna kompjuterike. Neni 293/a i Kodit Penal thotë se: “Përgjimi i paligjshëm me mjete teknike i transmetimeve jopublike, i të dhënave kompjuterike nga/ose brenda një sistemi kompjuterik, përfshirë emetimet elektromagnetike nga një sistem kompjuterik, që mbart të dhëna të tilla kompjuterike, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.” Po kështu, nenet 293/b dhe 293/c dënojnë veprat e ndërhyrjes në të dhënat kompjuterike dhe ndërhyrjes në sistemet kompjuterike, përkatësisht nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe nga tre deri në shtatë vjet. Edhe për këto vepra, krimi kundër rrjeteve me rëndësi të veçantë publike ka dënime më të ashpra sesa për rrjete të tjera.

Për hetimin e këtyre krimeve në Shqipëri janë ngritur Njësitë e Hetimit Kompjuterik pranë prokurorive në disa rrethe, si dhe si departamente të policisë. Sipas raportit të Ministrisë së Drejtësisë, në vitin 2018 vetëm 3 persona ishin dënuar në shkallë të parë për krimin kibernetik, dhe një tjetër në shkallë të dytë.

#sulmet cyber/hakerimi i sajteve

Sulmet kibernetike zakonisht përkufizohen si “hyrje me përdhunë” në sistemet e redaktimit online të palës së tretë (sulme DoS; fshirje e artikujve). Në Shqipëri nuk ka të dhëna për sulme të tilla në përgjithësi, dhe aq më pak ndaj gazetarëve. Këtu është e rëndësishme të mbahet parasysh se “këto lloj sulmesh online mund të jenë efikas në mbylljen e mediave, asfiksimin e tyre, duke llogaritur faktin që mediat të përballen me mungesë të ardhurash për atë periudhë kur e kanë të pamundur funksionimin” (*Raporti special rreth situatës dhe rasteve të kërcënimeve ndaj gazetarëve në Bosnje e Hercegovinë 2017: 49*).

Softueri qëllimkeq (angl. Malëare – malicious softëare) është ai softuer i projektuar të “infiltrtojë në sistemin kompjuterik” (pa dijeninë dhe pëlqimin e përdoruesit). Ky emërtim përfshin softuerët “keqdashës” që iu shkaktojnë dëme kompjuterave dhe përdoruesve të tyre (më të njohurit: programi spiunim, kali i trojës, viruset kompjuterike). Sipas udhëzimeve të Njësisë kundër krimit në fushë të teknologjisë së lartë dhe teknikës operative “mënyra më e thjeshtë dhe më efikase për t’u mbrojtur nga këto rreziqe është shfrytëzimi i një softueri antivirus të përshtatshëm”.

#cenimi i intimitetit

Ndodh atëherë kur përdoren (mblidhen e shfrytëzohen pa qenë të autorizuar) të dhëna vetjake të gazetarit. Kësaj sfere i përket edhe **public shaming** – i ashtuquajtur i “ndëshkim përmes privimit të personalitetit”. Online shaming/turpërimi është një formë e dhunës së ushtruar në internet përmes së cilës objekti poshtërohet publikisht falë shfrytëzimit të teknologjisë, siç janë mediat e reja dhe rrjetet shoqërore. Turpërimi online konsiston në publikimin në internet të informacioneve private (nën emërtimin **doxing**), çka shpesh shpije drejt mesazheve me përmbajtje urrejtjeje dhe kërcënimesh me vdekje si mjet për ta frikësuar personin që është bërë objekt i sulmit.

#keqpërdorimi i rrjeteve sociale

Rrjetet sociale shfrytëzohen si truall i volitshëm për lloje të ndryshme sulmesh, çka përfshin, përveç atyre përmendur këtu më lart, edhe spiunimin, befriending/following me synimin për t’u afruar me motive të paqarta/të dyshimta, përhapje dezinformimi në mënyrë anonime ose bërje propagande online.

#çfarë mund të bëhet?

- Shfrytëzimi i mjeteve online për të denoncuar përmbajtjen e padëshiruar
- Padi penale
- Denoncim me shkrim në mediat online, pranë Këshillit Shqiptar të Medias
- Kërkesa për ndihmë nga shoqatat e gazetarëve

#godigitalagainsttharassment

#parandalimi

Ka një sërë mënyrash parandaluese të mbrojtjes online të rekomandueshme për t'u përdorur. Zakonisht reagohet vetëm atëherë mbasi ka ndodhur dhuna (si njoftimi tek administratori), ndërkohë që ia vlen të shfrytëzohen disa këshilla të përgjithshme në mënyrë që puna dhe dukshmëria online e gazetarëve të jetë sa më e sigurtë.

Rrjeti lokal wireless (WLAN) është i ndjeshëm ndaj sulmeve, dhe pikërisht për këtë këshillohet kujdes dhe aktivizimi i të gjitha masave parandaluese e të sigurisë. Mbani përherë parasysh fjalëkalimet: është e nevojshme që t'i ndërtoni, duke qenë se fjalëkalimet prodhuesi/fabrika zakonisht të njohura prej të gjithëve. Po kështu “fjalëkalimet që përdoren për gjithfarësoj komunikimesh online (e-mail, rrjetet sociale, blogjet, forume etj.) duhet të jenë të sigurta (kombinimi i shkronjave, numrave, shenjave; shkronja të mëdha e të vogla; shmangiuni fjalëkalimeve të parashikueshëm si data, emra; herë pas herë ndërrojini fjalëkalimiet dhe mos i ruani në të njëjtin vend). Mos shfrytëzoni të njëjtin fjalëkalim për përdorime të ndryshme; për shembull, për të siguruar kompjuterin, hyrje në postën elektronike ose përdorime të tjera”.

Pjesa më e madhe e chat-eve përmban mundësinë e bllokimit ose të injorimit, përmes të cilave bëhet e mundur ndalimi i marrjes së mesazheve prej përdoruesve të padëshiruar. Në pjesën më të madhe të forumeve ekziston mundësia e “informimit të moderatorit” pa i rënë askujt në sy, domethënë me

një të klikuar mund ta vini në dijeni moderatorin për atë që po e keqpërdor forumin. Moderatorin ose administratorin është në gjendje ta fshijë atë llogari, ta paralajmërojë përdoruesin si dhe t'ia ndalojë hyrjen në rast e përsërit veprimin.

Në qoftë se nu dëshironi që blogu juaj të shfaqet në rezultatet e kërkimit, atëherë mund të krijoni një file më vete me të cilin i kërkoni shërbimit që merret me kërkimin që ta injorojë domenin tuaj. Ky file do të quhet robots.txt. Blogun mos e lini të hapur dhe kompjuterin pa e kontrolluar; mos fusni në blog informacione personale dhe të hollësishme.

Softueri antivirus duhet mbajtur rregullisht në përputhje me udhëzimet që gjenden në vetë programin. Në rastin kur sistemi juaj është infektuar me softuer keqdashës atëherë lind nevoja ta dezinfektoni internetin me ndihmën e softuerëve antivirus, ta skanoni kompjuterin dhe ta fshini softuerin keqdashës. Po kështu bëni rregullisht kopje të të gjitha të dhënave që janë të rëndësishme, duke qenë se nuk ekziston mbrojtje absolute prej viruseve dhe softuerëve të tjerë të padëshiruar.

Mënyra më e sigurtë e mbrojtjes së të dhënave prej personave të paautorizuar është që të siguroheni se këta persona nuk kanë akses në kompjuterin tuaj. Gjithsesi përse kohë që dërgoni të dhëna përmes postës elektronike nuk mund të keni siguri absolute që në të dhënat e nisura prej jush ka akses vetëm personi të cilit i dërgohen. Në këto raste rekomandohet përdorimi i kriptimit. Një prej programeve më të njohur të kriptografisë është

Pretty Good Privacy, i njohur edhe si PGP, por ka edhe një numër programesh të ngjashme që mund t'i gjeni në internet. Falë programeve të përmendur mund ta siguron postën elektronike, hard diskun, folder-in me të dhëna, madje edhe dokumente të caktuara në Word.

- Këshillat për parandalimin janë nxjerrë nga faqja web e Njësisë së teknologjisë së lartë kundër krimit dhe teknikës operative në Republika Srpska.

#1: sigurimi i provave për sulmet online

Për çdonjërin prej procedurave në vijim është e rëndësishme, ashtu si dhe në hapësirën offline, të sigurohet prova përkatëse që sulmi/dhuna online ka ndodhur. Në hapësirën online të dhënat për dhunën janë shumë të dukshme dhe të mundshme për t'u ruajtur, ndonëse duken të "pakapshme". Provat digjitale janë informacione të ruajtura, të marra ose të dërguara nga pajisja elektronike dhe të mbledhura për procedurën hetimore, duke qenë se, si të tilla, kanë një rëndësi të dorës së parë në procesin e vërtetimit të veprës së sulmit online. Thelbësore është: të bëhen komente screen shot, e-mail-e, mesazhe, tituj, tekste – pavarësisht nga fakti nëse bëhet fjalë për sulm të kryer në hapësirën private online (korrespondencë e brendshme, e-mail-e personale/profesionale, mesazhe në rrjetet sociale) ose publike (në portale, komente, staturë) – përveç atyre rasteve nëse një vepër e caktuar kërkon që sulmi të jetë kryer publikisht (siç është shpifja ose gjuha e urretjes). Të gjitha këto prova duhet të përmbajnë (duhet të jenë të dukshme) – titull/emër/nofkën e dërguesit (të jetë e dukshme që aksh person e ka dërguar përmbajtjen në fjalë), e-mail/profil/emër/nofkë që viktimë e përdor (të jetë e dukshme që përmbajtja i dërgohet viktimës), data e dërgimit, data e marrjes/hapjes/njoftimit, data e aksesit të tekstit të përmbajtjes (fjala vjen, kur viktimë e ka parë – e ka bërë screen shot-in), si dhe teksti me përmbajtjen i dhunshëm të jetë qartësisht

i lexueshëm. Rekomandohet ruajtja e provës në disa vende – kompjuterin personal, kompjuterin e punës, USB, mobitel, pajisje të tjera kompjuterike dhe, doemos, i printuar. Rekomandohet edhe përcjellja e linkeve, screenshoteve, e-mail-ave, mesazheve (dmth e asaj që përbën sulmin) avokatit, redaktorit, miqve, organeve të policisë, si diçka shtesë për ta siguruar materialin. Këto materiale janë të dobishme për të gjitha procedurat gjyqësore ose jashtë gjyqësore të përshkruara më poshtë, duke qenë se disa prej tyre përshkruajnë direkt detyrimin për të ofruar të njëjtën gjë (për ta "bërë të mundshëm" që akti i sulmit ka ngjarë). Sigurimi i këtyre materialeve dëshmon se, sidomos në hapësirën publike online, dhuna ka ndodhur (data, njoftimi) dhe ndalon që me fshirjen të "zhduket" përmbajtja e asaj që ka ndodhur. Po kështu është e rëndësishme edhe për identifikimin e atij që ka kryer sulmin (adresa IP), në ato raste kur vjen nga një person anonim (nickname).

#t'i drejtoresh redaktorit

Në ato raste kur dhuna ushtrohet drejtpërdrejt ndaj gazetarit, pra jo redaksisë (punëdhënësit), të

Në rast kërcënimesh me e-mail, ngacmimesh e ndjekjesh, dëshmi potenciale digjitale për organet kompetente (të cilat bëhen pjesë e procedurës zyrtare) përfshijnë si më poshtë:

- Kompjuterë
- Pajisje dore mobile
- Pajisje PDA ose adresarë
- Listë e thirrjeve telefonike
- Ditarë ose blloqe shënimesh për mbikëqyrje
- Prova për hetim të dhënash rreth viktimës
- E-mail-a, shënime, letra
- Dokumentacion financiar ose pronësie
- Stampim fotografish ose pamjesh
- Dokumente ligjore
- Informacion rreth veprimtarisë në internet
- Stampim hartash

drejtuarit redaktorit është një nga hapat e parë që duhen ndërmarrë. Nëse redaktori/punëdhënësi mund e dëshiron të ndërmarrë masa të mëtejshme në mbrojtje të gazetarit, kjo është çështje që lidhet me raste konkrete. Në rastet kur bëhet fjalë për freelance (gazetar të pavarur) mungesa e përkrahjes nga ana e redaktorit/redaksisë e bën atë më të ekspozuar dhe për rrjedhojë objekt më të shpesh të sulmesh. Atëherë rekomandohet që t'i drejtohet shoqatave të gazetarëve, marrja në konsideratë e mekanizmave institucionalë të mbrojtjes (denoncim në polici, Avokati i Popullit, padi). Një tjetër instrument është biseda me redaktorin për të parë mundësinë e shqyrtimit paraprak të komentit para se të botohet, sidomos atëherë kur priten sulme.

#Përgënjeshttrim

Gazetarët mund të kërkojnë publikimin e një korigjimi (përgënjeshttrimi) për atë çka nga ana e tyre konsiderohet e pavërtetë dhe fyese. E njëjta gjë paraqitet me shkrim me përmbajtjen e saktë që duhet të ketë korigjimi (data, vendi i botimit, emri i autorit nëse dihet) si dhe shpjegimi se çfarë është e pavërtetë në përmbajtjen e asaj që publikuar online. Kërkesa për ndreqje të përmbajtjes mund të bëhet në mënyrë të pavarur, ose përmes përfaqësuesit (një plotfuqishmi, më shpesh përmes një avokati). Duke qenë se jo të gjitha përmbajtjet e disponueshme online kanë tipare mediatike (siç janë, për shembull, profilet personale në rrjetet sociale) atëherë kjo procedurë përballet me kufizime në rastet e shpifjeve në internet.

#paraqitja e një kërkesë/denoncimi për të ndërmarrë procedurë disiplinore (mobing dhe ngacmim seksual)

Kërkesa denoncimi për të ndërmarrë një procedurë disiplinore bëhet në përputhje me

rregulloren që përcakton fillimin e procedurës disiplinore (punëdhënësit, institucionet publike). Përbri elementëve të detyrueshëm që përmban çdo kërkesë/denoncim, në kërkesën që lyp konfirmimin e mbajtjes së përgjegjësive për ngacmim seksual dhe shqetësime në bazë të gjinisë është shumë e rëndësishme parashtrimi i të gjithë elementëve të këtyre veprave.

Ciladoqoftë vepra penale ose pasja dijani për kryerjen e saj mund ta denonconi personalisht në strukturat zyrtare të policisë së shtetit, ku funksionon dhe Sektori i Hetimit për Krimet Kibernetike.

#2: denoncimi penal

I bëhet prokurorit kompetent, drejtpërdrejt (në mënyrë të pavarur ose përmes një avokati). Denoncimi i një veprë penale (për shembull, kërcënimi për shkak të detyrës *Cenimi i sigurisë*) mund të bëhet pranë drejtorisë kompetente të policisë (në vendbanimin e palës së dëmtuar ose në vendin ku është kryer akti). Denoncimi mund të bëhet me gojë dhe/ose me shkrim, duke paraqitur faktet (screenshot, printim nga portali-web, e-mail, rrjetet sociale ku të duket qartë burimi – link, autori i mesazhit, data). Drejtorja e policisë është detyruar ta trajtojë denoncimin, të identifikojë dërguesin, ta informojë personin e kërcënuar lidhur me identitetin e sulmuesit dhe t'ia kalojë prokurorit kompetent. Prokurori heton mbi ç'bazë është kryer denoncimi (saktësinë e veprës penale) dhe më pas merr vendimin për të nisur ose jo procedurën për kryerjen e veprës penale. Prokurori vendos vetë për natyrën e urdhrat për ndërmarrjen e hetimit dhe përmbajtjen e padisë, mbasi ka vendosur për kualifikimin e veprës penale. Pala paditëse duhet informuar për hetimin, si dhe ngritjen e padisë ose refuzimin e saj.

#padi dhe kundërvajtje

Bëhet fjalë për procedura të cilat për t'u ndërmarrë dhe për t'u trajtuar kanë nevojë për njohuri të një avokati (angazhim avokati). Ngritja e një padie nënkupton shpenzime – gjyqësore (taksa, dëshmitarë ekspertë) dhe shpenzime avokatie. Padia i paraqitet gjykatës kompetente. Ka mjete juridike kundër vendimeve të gjykatës.

#padi për dëm të shkaktuar nga shpifja

Me padinë për shpifje kërkohet që gjykata të vendosë se informacioni i publikuar është i pavërtetë dhe se për personin e dëmtuar (padiësin) kjo gjë përbën shpifje, dhe në bazë të kësaj gjykata të përcaktojë dëmshpërblim në një shumë të caktuar për dëmin e pësuar (sipas ligjit për marrëdhëniet e obliguara, “dëmi” trajtohet si diçka jo materiale që cenon nderi dhe reputacionin e personit). Në këtë kuptim kompensimi për dëmin bëhet vetëm me qëllim të kompensimit të cenimit të reputacionit të palës së prekur, dhe ky kompensim duhet të jetë në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar. Gjykata është e detyruar të pyesë nëse ekziston mundësia e pajtimit të palëve për t'iu shmangur vazhdimit më tej të procedurës gjyqësore. Duke qenë se përmbajtja është publikuar online rekomandohet sigurimi i fakteve lidhur me publikimin dhe burimin e përmbajtjes së përmbajtjes (screenshot prej nga të duket qartë linku i publikimit, autori, data e publikimit dhe data e aksesimit/printimit). Afati për të ngritur padi për mbrojtjen nga shpifja është tri muaj nga dita e marrjes vesh për publikimin e informacionit të pasaktë dhe identitetin e autorit të aktit (afat subjektiv) dhe një vit nga dita e publikimit të informacionit të pasaktë (afati objektiv).

#padi për ngacmim seksual

Në rast se personi dëshiron të ndërmarrë një procedurë gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi në rast ngacmimi, atëherë në padi duhet medoemos të theksohet: pozicioni i padëshiruar i viktimës; e kushtëzuar me ndonjë karakteristikë ose tipar të viktimës (për shembull, diskriminim në bazë të gjinisë); si objektiv ose rezultat i kësaj cenim i dinjitetit të padiësit; shkaktim frike, armiqësi, poshtërim ose mjedis fytes (për shembull, duke bërë që personi i dëmtuar ta ketë të vështirë të kryejë punën në mjedisin e formuar).

#padi të veçanta për mbrojtje nga diskriminimi (padi antidiskriminatore – duke përfshirë mobing dhe ngacmimin seksual)

Viktima që ka pësuar çfarëdo forme diskriminimi (duke përfshirë edhe mobing) mundet që përmes padisë të kërkojë: vërtetimin e diskriminimit (shkeljen e së drejtës për trajtim të barabartë); ndalimin ose eliminimin e diskriminimit (ndalimin e ndërmarrjes së veprimeve që shkelin ose mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, domethënë kryerjen e veprimeve që eliminojnë diskriminimin ose pasojat e tij); dëmshpërblim të dëmit të kryer (shpërblim për dëm material ose jo material të shkaktuar me cenimin e të drejtës bazuar në Ligjin që ndalon diskriminimin); publikimi i vendimit gjyqësor në mediat prej nga është kryer fyerja dhe shpenzimet e publikimit t'i ngarkohen personit të paditur. Sipas këtyre procedurave kur një person ose grup personash mbi bazën e provave në dispozicion të tyre bëjnë të mundur që diskriminimi ka ndodhur, atëherë barra e provës se diskriminimi nuk ka ndodhur qëndron në anën kundërshtuese.

Marrja dhe trajtimi i padisë për mbrojtje nga diskriminimi kryhet si procedurë civile (qytetare) dhe nënkupton shpenzime – gjyqësore (taksa, veprime) dhe shpenzime avokati. Kompetente është gjykata e rrethit/themelore është vendi ose selia e personit, institucionit shtetëror ose biznesit kundër të cilit është ndërmarrë procedura gjyqësore. Procedura nis me ngritjen e padisë dhe zhvillohet sipas rregullave të ligjit për entitetin të procedurës gjyqësore. Viktima e aktit diskriminues nxjerr para trupit gjykues faktet, paraqet dokumentet që vërtetojnë se është diskriminuar – personi i punësuar që padit duhet t'i paraqesë gjykatës fakte rreth sjelljes së pazakontë, të jashtëligjshme dhe të pamoralshme të punëdhënësit ose një personi tjetër të punësuar në atë vend, në mënyrë që të dëshmojë se personi në fjalë ka pasur si qëllim mobingun. Pas kësaj personi i akuzuar (punëdhënësi ose i punësuar) duhet të dëshmojë se nuk është fajtor, me fjalë të tjera që sjellja e tij nuk ka pasur si qëllim që bëj mobing. Si dëshmi për aktin e mobingut online mund të shërbejnë: çdo dokument i shkruar (i natyrës zyrtar ose jo zyrtar) që vjen nga autori i mobingut: komunikimi me shkrim me personin e mobingut (e-mail, mesazhe sms); thëniet e dëshmitarëve (kolegë ose persona të tretë që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së mobingut); dokumente mjekësore (që dëshmojnë dëmin e shkaktuar nga ana shëndetësore, si dhe marrëdhënien e saj psikike kundrejt punës, punëdhënësit e kolegëve shkaktuar si rrjedhojë e mobingut). Në këto raste iu rekomandohet të gjithë atyre që dyshojnë se janë viktima të mobingut që të mbajnë një ditar të posaçëm për këtë qëllim ku të shënojnë (përmes fakteve) çdo person nga vendi i punës për të cilin dyshon se bën mobing. Ditari në fjalë duhet të përmbajë data, kohën e saktë, listimin e personave që kanë ndërmarrë çfarëdolloj veprimi që lidhet me mobing, si dhe përshkrim të detajuar të veprimeve, dëshmitarëve eventuale, ose mënyrave të tjera

për të dëshmuar se si është mbërritur te ngjarja e pakëndshme.

#procedurë për kundravajtje

Procedura për kundërvajtje ndërmerret dhe zhvillohet me kërkesë të organit të autorizuar ose të palës së dëmtuar; urdhër kundërvajtje në përputhje me ligjet në fuqi. Procedura ndërmerret vetëm për ato vepra që parashikohen si kundërvajtje. Ligje të ndryshme përcaktojnë dispozitat e kundravajtjes dhe kompetencat e organit për të filluar procedurën për kundravajtje (për shembull ligji kundër diskriminimit, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ai i Avokatit të Popullit, në kuadër të kompetencave që i njej ligji mund të ndërmarrë procedurë për kundravajtje në rast kur ka diskriminim ndaj një individi, me fjalë të tjera të ndërhyjë gjatë procedurës që po kryhet, atëherë kur mendon se kjo gjë është e domosdoshme për kryerjen e funksioneve dhe detyrave të veta); denoncimi mund të kryhet pranë drejtorisë së policisë drejtpërdrejt nga ana e gazetarit (palës së dëmtuar), si dhe mund të bëhet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Procedura për kundravajtje kryhet para gjykatës kompetente.

#4: të tjera

#ankesë drejtuar institucionit të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi

Ankesa bëhet me shkrim përmes postës, faksit, e-mail ose duke dorëzuar personalisht. Ankesa duhet të përmbajë: a) emrin e ankuesit; b) shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi; c) subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin, ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij; ç) shpjegimin e diskriminimit të pretenduar; d) masat që kërkohen nga komisioneri;

dh) datën dhe firmën e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij. Institucioni mund të refuzojë të shqyrtojë ankesa nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankësës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt.

Me marrjen e ankësës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër. Gjithashtu, nëse është e përshtatshme, mund të zhvillohet një seancë dëgjimore publike dhe komisioneri fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar. Është gjithnjë e mundur të bëhet përpjekja për të arritur një marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Më tej Komisioneri shprehet me vendim, i cili përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni

me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Ky institucion nuk merr përsipër të përfaqësojë personin që ka bërë ankësën para organeve publike dhe nuk merr përsipër të shkruajë padi në emër të tyre. Ankësë në adresë të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të bëjë një gazetar i pavarur që është bërë viktimë e mobingut. Paraqitja e ankësës dhe hapja e procedurës pranë këtij institucioni është pa pagesë dhe nuk ka nevojë për ndihmën e këshilltarit ose të avokatit.

#shfrytëzimi i instrumenteve online për denoncimin e teksteve me përmbajtje të papërshtatshme

Heqja e teksteve nga rrjetet sociale është opsioni që ofrojnë rrjetet online më të njohura/më popullore. Kërkesat për heqjen e tekstit janë të aksesueshëm në çdonjërin prej rrjeteve (për shembull, Facebook, Instagram, Twitter, YouTube). Njoftimin për përmbajtje të papërshtatshme (fjala vjen, për shkak të përmbajtjes fyese, gjuhës së urrejtjes) Facebook do ta marrë në shqyrtim pas denoncimit, por se sa ky proces zgjat dhe nëse do ta pezullojë përmbajtjen e papërshtatshme ose krejt profilin për këtë nuk ka garanci as rregulla (ekziston mundësia të mos reagojë aspak). Në vitin 2017 Twitter-i njoftoi se gjuhën e urrejtjes në fotografi do ta trajtojë si dhunë grafike dhe përmbajtjen për të rritur; ndalimi i përmbajtjes së dhunshme ka të bëjë edhe me përmbajtjen e profileve të përdoruesve. Twitter premtoi se do të pezullonte e fshinte çdo njoftim të përdoruesve që ngrenë lart dhunën, në vend të asaj që kishin bërë deri më atëherë, ndalimit të twitter-ave (për denoncimin e një twitter-i me përmbajtje të papërshtatshme zgjidhni opcionin e fundit “it’s abusive or harmful”), që

promovonin kërcënimet. YouTube reagon shpejt dhe fshin videofilmimet dhe përmbajtjen e tyre mbasi vlerëson se me të drejtë janë denoncuar si të papërshtatshme. Ekziston mundësia e heqjes së përmbajtjes së caktuar prej instrumenteve hetues ose zhvendosja e tyre pas rezultateve të hulumtimit (p.sh. Google që reagon më shpejt lidhur me shqyrtimet merr edhe denoncimet individuale dhe përgjigjet brenda afatit të 24 orëve). Pajtimi për çdo shërbim online është i aksesueshëm me çdo përmbajtje të publikuar.

Po kështu, Twitter ua ka ndaluar përdoruesve të keqpërdorin ose të kërcënojnë të tjerët përmes informacioneve në profil, duke përfshirë edhe

emrin e përdoruesit. Mbrojtja e përdoruesve lidhet me ndalimin e “kërcënimit me dhunë kundër të tjerëve, ose promovimin e dhunës kundër të tjerëve”. Ndalimi ka të bëjë jo vetëm me kërcënimin e drejtëpërdrejtë përmes twitter-it, por edhe me vetë kontekstin e twitter-ave dhe të komunikimit, veçanërisht në rastet kur një numër i madh përdoruesish, si grup, keqtrajtojnë një person të caktuar ose një grup njerëzish. Përdoruesit që sillen në këtë mënyrë kërcënohen me mbylljen e profilit për një kohë të caktuar ose ngaherë, por edhe me autorizimin e detyruar të profilit telefonik, me anë të të cilit pakësohet niveli i profileve anonimë.

#godigitalagainstharassment

- Komente anonime** ● Pamundësia për të identifikuar autorin e komentit. Një numër i madh vendesh i lejojnë komentet anonime të përdoruesve online, por kjo praktikë ka rezultuar mjaft problematike (kërcënime, gjuhë urrejtje, vulgaritete).
- Administratori verifikues** ● Pjesa më e madhe e portaleve në BeH nuk përdor administrator verifikues kur është fjala për komentet. Komentet janë të hapura dhe kryesisht anonime dhe më të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes, kërcënimeve dhe vulgariteteve. Përvoja e portaleve online që përdorin administratorë verifikues ose ndonjë mjet tjetër të kontrollit të komenteve, tregon se është e mundur të mbrohesh prej kërcënimeve dhe vulgariteteve.
- Autocensura** ● Vetëcensura e gazetarit – kufizimi i ndërgjegjshëm i lirisë për shkak të kontrolleve të mundshme zyrtare. Kufizimi i lirisë mediatike dhe shprehjes publikisht me vullnet të lirë, si për shkak të trusnisë së pushtetit ose grupeve të forta të interesit për shkak të ndikimeve politike dhe të rrethanave shoqërore, frikës nga pasojat që mund të vinë prej të vërtetës, për arsye karriere dhe përfitimi material.
- Censura** ● Në kuptim e gjerë të fjalës censura është mbikëqyrja dhe kufizimi i lirisë së shprehjes. Synon në kontrollin e publikimeve, mediave, letërsisë zbavitëse dhe gjërave të ngjashme, si e si për të ndaluar cenimin e interesave të pushtetit, shtetit, elitave ose normave shoqërore.

Neni 10-të i Konventës europiane ● (1) Gjithkujt i njihet e drejta e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit, lirinë e marrjes dhe të përcjelljes informacion ose ide, pa përzierjen e organeve të pushtetit dhe pa kufi. Ky nen i ndalon shtetet të kërkojnë leje lidhur me punën e kryer nga radiot, televizionet ose kompanitë filmike.

(2) Krijimi i këtyre lirive, duke përfshirë edhe detyrimet e përgjegjësitë që rrjedhin prej tyre, mund edhe të bëhen objekt i formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të të sigurisë kombëtare, parandalimit të turbullirave ose krimeve, mbrojtjes së shëndetit dhe të moralit, personalitetit ose të drejtave të të tjerëve, parandalimit të përhapjes së informacioneve të rezervuara ose në interes të ruajtjes së autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit”.

Neni 19. Deklarata për të drejtat e njeriut ● Çdo njeri gëzon të drejtën e lirisë së mendimit e të shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa presion nga jashtë, lirinë e kërkimit, marrjes dhe shpërndarjes së informacioneve e ideve përmes mjeteve publike dhe komunikimit publik pa kufi.

Doxing ● Nënkupton hetimin dhe transmetimin e të dhënave personale për një individ, shpesh me synimin për ta dëmtuar atë. Shpesh mbërrihet në zhvatje, shtrëngime, ngacmime dhe forma të tjera keqtrajtimi.

Konventa për krimin kibernetik (ose Konventa për krimin në fushë të teknologjisë së lartë) ● Kjo konventë hyn te “konventat kuadër”, duke pasur parasysh faktin që rregullat e saj nuk përftohen drejtpërdrejtë dhe çdo shtet duhet ta implementojë në kuadrin ligjor të vendit. Konventa parashikon katër grupe të veprës penale: 1) veprë penale ndaj besueshmërisë, integritetit dhe disponibilitetit të të dhënave dhe sistemit kompjuterik (akses i palejuar, ndërprerje e paligjshme, cenim i integritetit

(pengim) i të dhënave, cenim i integritetit (pengim) i sistemit, keqpërdorim i pajisjeve; 2) vepër penale kompjuterike (falsifikim/keqsajim, mashtrim/mashtrime); 3) vepër penale në lidhje me përmbajtjen e tekstit (pornografi të miturish); 4) vepër penale lidhur me pronësinë intelektuale.

- Vepër penale** ● Vepër që bie ndesh me ligjim dhe që juridikisht përcaktohet si vepër penale, karakteristikat e së cilës parashikojnë sanksione ligjore. Një vepër penale mund të kryhet përmes veprimit, por edhe mosveprimit.
- Kallëzim penal** ● Njoftim për prokurorin kompetent për kryerjen e veprës penale. Kallëzimi mund të bëhet me shkrim ose me gojë.
- Kufizimi i lirisë së shprehjes** ● Liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute: ajo edhe mund t'i nënshtrohet një sërë kufizimesh të caktuara, por vetëm atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të domosdoshme për shkak të respektimit të të drejtave dhe reputacionit të personave të tjerë; ruajtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik, shëndetit ose moralit.
- Thirrje për dhunë** ● Çdo shprehje ideje ose opinionit urrejtjeje që ka për qëllim të nxisë persona të tjerë të kryejnë vepra të ndaluara nga ligji. As edhe një prej dispozitave ligjore penale në Bosnje e Hercegovinë që ka të bëjë me këtë vepër penale, nuk e përmban shprehjen “thirrje për” ose një formulim ekuivalent që tregon se komunikimi i informacioneve ose i ideve duhet të jetë një element thelbësor i nxitjes dhe inkurajimit.
- Public shaming (turpërimi publik)** ● Publikimi i informacioneve gjysmë private për gazetarët në një platformë përmbajtja e së cilës është e aksesueshme në masë të madhe nga publiku me qëllim për ta frikësuar.

Liria e shprehjes ● Ka të bëj me lirinë për të pasur mendim pa u ndikuar nga presione nga jashtë, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes e shpërndarjes së informacionit dhe ideve përmes çfarëdolloj mjete të informimit publik dhe pa marrë në konsideratë kufitë. Kur cenohet liria e shprehjes kjo nuk është cenim i së drejtës së një personi [gazetari], por bashkë me të cenohet edhe e drejta e njerëzve të tjerë për të “përfutur” informacione dhe ide. Çdokush gëzon të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes.

Trol (trolling) ● Shprehje verbale tejet agresive dhe fyese që ka si synim bllokimin ose asgjësimin e një bisede. Nuk është e thënë që të drejtohet kundër një gazetari të caktuar, ndërkohë që merret me rolin e gazetarit në përgjithësi përkrah kolegëve dhe komenteve të ndryshme. Në ato raste kur drejtohet kundër një gazetari (ose një komentuesi) me qëllimin për ta frikësuar, trolling konsiderohet keqtrajtim. Më së shumti trollin përmban sharje dhe fyerje.

Përgjegjësia redaktoriale ● “Përgjegjësia më e madhe dhe e rëndësishme e gazetarit dhe e redaktorit është të sigurojnë që krejt puna e tyre të orientohet nga respekti për të vërtetën, si dhe e drejta e publikut të mësojë të vërtetën. Në çdo kohë gazetari duhet ta kryejnë punën në frymën e drejtësisë, vërtetësisë dhe dinjitetit, duke mbledhur informacionin, raportuar atë dhe parashtruar mendimet e veta. Plagjiatura, falsifikimi, fshehja e qëllimtë e fakteve të rëndësishme, marrja e mitës ose shërbimet që ndikojnë mbi punën e raportuesit ose redaktorit, janë shkeljet më të rënda morale të këtij profesioni”. (Kodi për shtypin në BeG, neni 2).

LITERATURA

Libra e publikime

A Difficult Profession Media Freedom Under Attack in the Western Balkans (2015). Human Rights Watch. Dostupno na: <https://www.hrw.org/report/2015/07/15/difficultprofession/media-freedom-under-attack-western-balkans> (stranica posjećena 4.4.2018).

Bieber, F., Kmezić, M. (2015). *Media Freedom in the Western Balkans*, Authors: Balkans in Europe, Policy Advisory Group. Dostupno na: <http://www.biepag.eu/publications/media-freedom-in-the-western-balkans/> (stranica posjećena 14.4.2018).

Cvjetičanin, T., Sali-Terzić, S., Dekić, S. (2010). *Strategije isključivanja: govor mržnje u BH javnosti*. Sarajevo: Mediacentar. Dostupno na: <http://www.media.ba/bs/content/consec-tuetuer-iustum-rusticus-utinam> (stranica posjećena 15.4.2018).

Griffen, S. (2017). *Defamation and Insult Laws in the OSCE Region: A Comparative Study*, OSCE Representative on Freedom of the Media. Dostupno na: <https://www.osce.org/fom/303181> (stranica posjećena 5.4.2018).

Halilović, M., Džihana, A. (ur.). (2012). *Medijsko pravo u Bosni i Hercegovini*. Sarajevo: Internews u Bosni i Hercegovini.

Henrichsen, J., Betz, M., Lisosky, J. (2015). *Building Digital Safety For Journalism - A Survey Of Selected Issues*, Paris: UNESCO. Dostupno na: <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002323/232358e.pdf> (stranica posjećena 30.3.2018).

Hodžić, E., Mehmedić, A. (ur.). (2014). *Krivična djela počinjena iz mržnje: izazovi reguliranja i procesuiranja u BiH*. Sarajevo: Analitika – Centar za društvena istraživanja.

Irion, K., Cavaliere, P., and Pavli, D. 2015. Comparative study of best European practices of online content regulation. Law and policy of online content regulation, in particular defamation online, in the light of Al-banian legislative proposals. Study commissioned by the Council of Europe, Amsterdam/ Edinburgh/ Tirana, August

“Kodeks za štampu i online medije BiH”. Dostupno na: https://www.vzs.ba/index.php?option=com_content&view=article&id=218&Itemid=9 (stranica posjećena 14.4.2018).

Krivična djela počinjena iz mržnje: Regulatorna i praksa u BiH. Dostupno na: <https://opservatorij.wordpress.com/krivicna-djela-pocinjena-iz-mrznje-regulatorna-i-praksa-ubih-11/> (stranica posjećena 15.4.2018).

Krivično djelo izazivanja nacionalne, rasne i vjerske mržnje, razdora ili netrpeljivosti: Nepreciznost norme i problemi u njenoj praktičnoj primjeni u Bosni i Hercegovini (Policy memo). (2016). Analitika – Centar za društvena istraživanja. Dostupno na: <http://www.analitika>

ba/sites/default/files/publikacije/policy_memo_-_izazivanje_mrznje_-_web_-_19decembar_0.pdf (stranica posjećena 15.4.2018).

Letinić, A., Horvat, M., Sesar, J., Mrakovčić, M. (ur). (2016). *Čitajmo između redaka – Priručnik za razvoj medijske pismenosti*. Zagreb: GONG i KURZIV. Dostupno na: http://www.gong.hr/media/uploads/med_pismenost_pub.pdf (stranica posjećena 22.4.2018).

Maljević, A. , Vujović, S. (2013). *Vodič za procesuiranje krivičnih djela počinjenih iz mržnje u Bosni i Hercegovini*. Sarajevo: Analitika – Centar za društvena istraživanja.

Media Freedom and Integrity in the Western Balkans: Recent Developments (2015).

European Fund for the Balkans. Dostupno na: <http://balkanfund.org/wp-content/uploads/2015/03/Media-freedom-and-integrity-in-the-Western-Balkans-Recentdevelopments.pdf> (stranica posjećena 14.4.2018).

New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists (2016). OSCE Representative on Freedom of the Media. Dostupno na: <https://www.osce.org/fom/220411?download=true> (stranica posjećena 30.3.2018).

Petković, B., Hodžić, S.(ur) (2014). *Značaj medijskog integriteta: Vraćanje medija i novinarstva u službu javnosti*. Sarajevo: Fondacija za razvoj medija i civilnog društva “Mediacentar”.

Porobović, M., Bajraktarević, M. (2012.). *Cyber crime, pranje novca i finansijske istrage*. Dostupno na: <https://csd.pravosudje.ba/vstv/faces/faces/> (stranica posjećena 30.3.2018).

Priručnik za postupanje ombudsmana za ljudska prava Bosne i Hercegovine u predmetima diskriminacije (2016). Sarajevo: Institucija ombudsmana/ombudsmana za ljudska prava Bosne i Hercegovine. Dostupno na http://www.ombudsmen.gov.ba/documents/obudsmen_doc2016101419280006eng.pdf (stranica posjećena 15.4.2018).

Raosavljević, P. *Govor mržnje u Bosni i Hercegovini - unapređenje regulative u BiH u skladu sa međunarodnim standardima*. Dostupno na: <http://univerzitetpim.com/wp-content/uploads/2016/11/Govor-mrznje-u-Bosni-i-Hercegovini.pdf> (stranica posjećena 14.4.2018).

Sali-Terzić, S. (2013). *Govor mržnje u BiH: Međunarodni standardi ljudskih prava i pravni okvir u BiH*. Dostupno na: <http://bhnovinari.ba/bs/2013/01/15/govor-mrnjemeunardon-standardi-ljudskih-prava-i-pravni-okvir-u-bih/>(stranica posjećena 14.4.2018).

Sloboda izražavanja, zakon o medijima i novinarska kleveta. Dostupno na: [http://www.mediadefence.org/sites/default/files/resources/files/MLDI.IPI%20defamation%20 manual.Croatian.pdf](http://www.mediadefence.org/sites/default/files/resources/files/MLDI.IPI%20defamation%20manual.Croatian.pdf) (stranica posjećena 4.4.2018).

Specijalni izvještaj o položaju i slučajevima prijetnji novinarima u Bosni i Hercegovini (2017). Sarajevo: Banja Luka: Institucija ombudsmana za ljudska prava BiH. Dostupno na: http://www.ombudsmen.gov.ba/documents/obudsmen_doc2017082415202346bos.pdf (stranica posjećena 4. 4. 2018).

Srdić, M. (2007). *Kratka analiza sudske prakse u primjeni Zakona o zaštiti od klevete*. Dostupno na: <http://www.bih-pravo.org/kratka-analiza-sudske-prakse-primjenizakona-zastiti-klevete-t723.html> (stranica posjećena 5.4.2018).

Škrbić, N. (2017). *Postupak za zaštitu od klevete*. Banja Luka: Advokatska firma “Sajić”. Dostupno na: <http://advokatskafirmasajic.com/wp-content/uploads/2014/03/postupak-za-zastitu-od-klevete.pdf> (stranica posjećena 2.4.2018).

Turčilo, L. *Govor mržnje u bh. javnom prostoru: Medijski i vanmedijski akteri*. Dostupno na: http://www.fes.ba/files/fes/img/Bilder_Aktivitaeten/GOVOR%20MRZNJE%20II.pdf (stranica posjećan 3.4.2018).

Turčilo, L., Buljubašić, B. (2017). *Mediji i shrinking space u Bosni i Hercegovini: Utišani alternativni glasovi*. Sarajevo: Fondacija Heinrich Böll, Ured za Bosnu i Hercegovinu, Makedoniju i Albaniju.

Tofalvy, T. (2017). *Online Harassment of Journalists in Hungary – Forms, Coping Mechanisms and Consequences for Press Freedom*, International Press Institute. Dostupno na: https://ipi.media/wp-content/uploads/2017/03/006_Hungary_Report_Online_2017.pdf (stranica posjećena 5.4.2018).

Vogt, J. (2017). *Online Harassment of Journalists in Austria*, International Press Institute. Dostupno na: https://ipi.media/wp-content/uploads/2017/08/Final_Austria_Report_Online_ENG_2017.pdf (stranica posjećena 5.4.2018).

Zakoni o krivičnim djelima počinjenim iz mržnje: Praktični vodič. Misija OSCE-a u Bosni i Hercegovine. Dostupno na: <https://www.osce.org/bs/odihr/36429?download=true> (stranica posjećena 14.4.2018).

Artikuj online dhe njoftime për publikun

A.D. *Govor mržnje raste, Tužilaštvo BiH nije procesuiralo nijedan slučaj*. 29.3.2018: Radio Sarajevo. Dostupno na: <https://www.radiosarajevo.ba/vijesti/bosna-i-hercegovina/govor-mrznje-raste-tuzilastvo-bih-nije-procesuiralo-nijedan-slucaj/295348> (stranica posjećena 19.4.2018).

Cyber Bullying: What is it? And What Can You Do?, The Phoenix Society. Dostupno na: <https://www.phoenix-society.org/resources/entry/cyber-bullying> (stranica posjećena 12.4.2018).

Combating Digital Harassment, 27.4.2016: Committee to Protect Journalists. Dostupno na: <https://cpj.org/2016/04/attacks-on-the-press-combating-digital-harassment.php> (stranica posjećena 4.4.2018).

CPJ Safety Advisory: Trolls and online abuse, 20.1.2017: Committee to Protect Journalists. Dostupno na: <https://cpj.org/2017/01/cpj-safety-advisory-trolls-andonline-abuse.php> (stranica posjećena 19.4.2018).

Đugum, A. *Novinari, glineni golubovi BiH*, 28.8.2017: Radio Slobodna Evropa. Dostupno na: <https://www.slobodnaevropa.org/a/novinari-sitraivanje-polozajbih/28701587.html> (stranica posjećena 16.4.2018).

European Commission – Press release (2016). *European Commission and IT Companies announce Code of Conduct on illegal online hate speech, Brussels*. Dostupno na: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1937_en.htm (stranica posjećena 15.4.2018).

Evropska komisija, *Parlamentarna pitanja: Odgovor gđe Jourove u ime Komisije* (2016).

Dostupno na: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getAllAnswers.do?reference=E-2016-005976&language=HR> (stranica posjećena 15.4.2018).

- Halilović, M. *Tužbe za klevetu protiv novinara – sredstvo pritiska na medije*, 12.1.2018: BH Novinari. Dostupno na: <http://bhnovinari.ba/bs/2018/01/12/tuzbe-za-klevetuprotiv-novinarasredstvo-pritiska-na-medije/>(stranica posjećena 13.4.2018).
- Halilović, M. *Mitovi i zamke: Šta je kleveta i kako je podnijeti?*, 1.9.2015.: Žurnal.info. Dostupno na: <http://www.zurnal.info/novost/19243/mitovi-i-zamke-sta-je-kleveta-i-kako-je-podnijeti> (stranica posjećena 5.4.2018).
- Halilović, M. *Primjena novog zakona o zaštiti od klevete u BiH: novinari nisu previše profitirali*, 24.3.2005: Media Online. Dostupno na: <http://www.media.ba/bs/etikaregulativa-novinarstvo-etika/primjena-novog-zakona-o-zastiti-od-klevete-ubih-novinari-nisu> (stranica posjećena 4.4.2018).
- Isović, M. *Znate li šta je kleveta?*, 23.5.2013: Inmedia. Dostupno na: <https://www.inmedia.ba/znate-li-sta-je-kleveta/> (stranica posjećena 5.4.2018).
- Kršo, M. *Najviše tužbi protiv novinara u BiH podnose političari*. 10.2.2018: N1. Dostupno na: <http://ba.n1info.com/a242711/Vijesti/Vijesti/Najvise-tuzbi-protiv-novinarau-BiH-podnose-politicari.html> (stranica posjećena 5.4.2018).
- Luque, J. *The five elements of coordinated online attacks against journalists*, 9.5.2017: International Press Institute. Dostupno na: <https://ipi.media/the-five-elements-ofcoordinated-online-attacks-against-journalists/> (stranica posjećena 4.4.2018).
- MCOOnline Redakcija. *Anonimni komentari i urednička odgovornost*, 17.1.2013: Media Online. Dostupno na: <http://www.media.ba/bs/vijesti-i-dogadaji-vijesti/anonimnikomentari-i-urednicka-odgovornost> (stranica posjećena 3.4.2018).
- MCOOnline Redakcija. *Online mediji u Srbiji i Hrvatskoj: Pritisci, prijetnje i neredovnepláce*, 9.11.2016: Media Online. Dostupno na: <http://www.media.ba/bs/magazinnovinarstvo/online-mediji-u-srbiji-i-hrvatskoj-pritisci-prijetnje-i-neredovne-place>(stranica posjećena 14.4.2018).
- Popov Momčinović, Z. (2018). *Napadi na novinarke u Bosni i Hercegovini u kontekstuugrozavanja medijskih sloboda*. Dostupno na: http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2018/04/NAPADI-NA-NOVINARKE-U-BOSNI-I-HERCEGOVINI_19.02.2018..pdf (stranica posjećena 12.4.2018).
- Preventing Online Harassment and Promoting Freedom of Expression: Draft IFJ Online Harassment Social Media Policy (for media houses)*, 31.3.2016: The International Federation of Journalists. Dostupno na: http://www.ifj.org/fileadmin/documents/IFJ_Online_Harassment_Social_Media_Policy.pdf (stranica posjećena 12.4.2018).
- Ristivojević, B. *O govoru mržnje*, 16.10.2010: <http://www.nspm.rs/politicki-zivot/ogovoru-mrznje.html?alphabet=1> (stranica posjećena 16.5.2018).
- Sokol, A. *Dragan Bursać: “Naša jedina i najbolja zaštita je apsolutna javnost”*, 6.2.2018: Media Online. Dostupno na: <http://www.media.ba/bs/magazin-novinarstvo/draganbur-sac-nasa-jedina-i-najbolja-zastita-je-apsolutna-javnost> (stranica posjećena 12.4.2018).
- Sprječavanje nezakonitoga govora mržnje na internetu – neprestani napredak inicijative Komisije, pridružuju se druge platforme*, 19.1.2018: Delegation of the European Union to Bosnia and Herzegovina. Dostupno na: <http://europa.ba/?p=54568> (stranica posjećena 15.4.2018).

Srdić, M. (2007). *Kratka analiza sudske prakse u primjeni Zakona o zaštiti od klevete*. <https://vsud-fbih.pravosudje.ba/vstv/faces/docservlet> (stranica posjećena 2. 4. 2018).

Strožijim kaznama umanjiti govor mržnje na internetu, 21.3.2017: Fokus. <https://www.fokus.ba/vijesti/bih/strozijim-kaznama-umanjiti-govor-mrznje-nainternetu/669206/> (stranica posjećena 14.4.2018).

Turčilo, L. *Online portali u BiH: Vjerodostojnost na kušnji*, 21.3.2017: Mediacentar Online. Dostupno na: <http://media.ba/bs/mediametar/online-portali-u-bihvjerodostojnost-na-kusnji> (stranica posjećena 15.4.2018).

Žuna, E. *Umjesto demantija, Talirevićeve vulgarne uvrede novinarki*, 28.7.2016: Media Online. Dostupno na: <http://media.ba/bs/mediametar/umjesto-demantijatalireviceve-vulgarne-uvrede-novinarki> (stranica posjećena 19.4.2018).

Ligje dhe akte të tjera ligjore

“Zakon o komunikacijama BiH”. *Službeni list Bosne i Hercegovine* 31/03, 75/06,32/10.

“Zakon o radu Federacije BiH”. *Službeni list Federacije Bosne i Hercegovine* 26/16.

“Zakon o radu Republike Srpske”. *Službeni glasnik Republike Srpske* 1/16.

“Zakon o zaštiti od klevete Federacije BiH”. *Službeni list Federacije Bosne i Hercegovine* 19/03, 73/05.

“Zakon o zaštiti od klevete Republike Srpske”. *Službeni glasnik Republike Srpske* 37/01.

“Zakon o zaštiti od klevete Brčko Distrikta”. *Službeni glasnik Brčko Distrikta BiH* 14/03.

“Zakon o krivičnom postupku BiH”. *Službeni list Bosne i Hercegovine* 3/03, 32/03, 36/03, 26/04, 63/04, 13/05, 48/05, 46/06, 76/06, 29/07, 32/07, 53/07, 76/07, 15/08, 58/08, 12/09, 16/09, 93/09, 72/13.

“Zakon o krivičnom postupku Federacije BiH”. *Službeni list Federacije Bosne i Hercegovine* 35/03, 37/03, 56/03, 78/04, 28/05, 55/06, 27/07, 53/07, 9/09.

“Zakon o krivičnom postupku Republike Srpske”. *Službeni glasnik Republike Srpske* 53/12, 91/17.

“Zakon o ombudsmenu za ljudska prava Bosne i Hercegovine”. *Službeni glasnik Bosne i Hercegovine* 32/00, 35/04 i 32/06.

“Zakon o parničnom postupku FBiH”. *Službeni list Federacije BiH* 53/03, 73/05, 19/06, 98/15.

“Zakon o parničnom postupku RS”. *Službeni glasnik Republike Srpske* 72/11, 49/13, 74/13, 55/14.

“Zakon o parničnom postupku Brčko distrikta BiH”. *Službeni glasnik Brčko distrikta BiH* 8/09, 52/10 i 27/14

“Zakon o zabrani diskriminacije”. *Službeni glasnik BiH* 59/09, 66/16

Recommendation CM/Rec(2016)4[1] of the Committee of Ministers to member States on the protection of journalism and safety of journalists and other media actors. Dostupno na: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#_ftn1 (stranica posjećena 12.4.2018).

Ustav Bosne i Hercegovine, prijevod na bosanski jezik. Dostupno na: http://www.ccbh.ba/public/down/USTAV_BOSNE_I_HERCEGOVINE_bos.pdf (stranica posjećena 16.4.2018).

“Zakon o javnom redu i miru Republike Srpske”. *Službeni glasnik Republike Srpske* 20/07, 11/15.

Evropska konvencija o ljudskim pravima i osnovnim slobodama. Dostupno na: <http://msb.gov.ba/dokumenti/medjunarodni/?id=2665> (stranica posjećena 21.4.2018). *Univerzalna deklaracija o ljudskim pravima.* Dostupno na: http://www.ombudsman.co.me/docs/deklaracija_o_ljudskim_pravima.pdf (stranica posjećena 21.4.2018).

Međunarodni pakt o građanskim i političkim pravima. Dostupno na: <http://www.mhrr.gov.ba/PDF/MedunarodniPakt%20B.pdf> (stranica posjećena 21.4.2018).

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë

Ligi Nr.10 221, datë 4.2.2010 Për mbrojtjen nga diskriminimi.”

Burime në Internet:

Agencija zaravnopravnost spolova BiH, <http://arsbih.gov.ba/>

Diskriminacija: <http://www.diskriminacija.ba/>

Institucija ombudsmena za ljudska prava Bosne i Hercegovine: <http://www.ombudsmen.gov.ba/Default.aspx?id=0&lang=BS>

Jedinica za visokotehnološki kriminalitet i operativnu tehniku RS: http://mup.vladars.net/vtk/home_lat.html

Tužilaštvo Bosne i Hercegovine: <http://www.tuzilastvobih.gov.ba/>

Udruženje/udruga BH Novinari: <http://bhnovinari.ba/bs/>

Vijeće za štampu BiH: <http://vzs.ba/>

Visoko sudsko i tužilačko vijeće Bosne i Hercegovine: <https://www.pravosudje.ba>

<https://rm.coe.int/168047080a>

Rreth autoreve

Lejla Gačanica. Është diplomuar në drejtësi. Aktualisht punon si këshilltare ligjore dhe hulumtuese e pavarur. Është specializuar në drejtësi dhe të drejtën e autorit (ka dymbëdhjetë përvojë në këtë fushë) dhe në të drejtën kushtetuese. Bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile në BeH dhe në rajon prej afro dhjetë vjetësh. Fusha e veprimtarisë së saj ka të bëjë me përballjen me të kaluarën kujtesën në fushë të kulturës, të drejtave të njeriut, shoqërisë pas konfliktit etj. Është autore e një sërë artikujsh, analizash, punimesh kërkimore e shkencore në fushat e lartpërmendura.



Marija Arnautović u lind në Nikshiç, Mal të Zi. Ka studiuar në fakultetin e shkencave politike, dega e politikologjisë në universitetin e Beogradit. U diplomua në vitin 1998. Po atë vit u punësua gazetare në Radion e Malit të Zi. Nga viti 2002 deri më 2003 punoi si redaktore e agjencisë së lajmeve të Malit të Zi, MINA. Nga viti 2003 deri më 2004 punoi si gazetare dhe redaktore e lajmeve e Televizionit të Kantonit të Sarajevës. Nga viti 2004 punon në redaksinë e Radios Europa e Lirë në Sarajevë, si gazetare-reportere, redaktore lajmesh. Është edhe redaktore e drejtuese e revistës TV Liberty. Punon si trajnere në Media Centër në Sarajevë.



PREFS